



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT
INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT

PROGRAM ORIENTUES PËR TESTIMIN E KANDIDATËVE TË LËNDËS “KIMI”

I. HYRJE

Programi orientues për testimin e kandidatëve të lëndës së kimisë është hartuar nga grupi i punës, i ngritur nga Instituti i Zhvillimit të Arsimit (IZHA), për t’u ardhur në ndihmë të gjithë kandidatëve që duan të ushtrojnë profesionin e mësuesit në lëndën e kimisë. Ky program përfaqëson dhe përmbush njëherazi, kurrikulën e zhvillimit të vazhdueshëm profesional të mësuesit dhe përgatitjen për testimin e formimit të përgjithshëm dhe shkencor të kandidatit. Programi është hartuar në përgjigje të kërkesave që MAS ka vendosur për kandidatët që testohen. Programi përcakton njohuritë dhe aftësitë kryesore sipas fushave të mëposhtme:

- Dokumente zyrtare¹ të cilat kanë të bëjnë me veprimtarinë mësimore- edukative të mësuesve.
- Programe lëndore të kimisë.
- Aspekte të pedagogjisë, metodologjisë dhe përdorimit të TIK-ut në mësimdhënie-nxënien e lëndës së kimisë.
- Aspekte të etikës dhe të komunikimit.
- Aspekte të drejtshkrimit të gjuhës shqipe.
- Përmbajtja shkencore sipas programeve lëndore të kimisë.

II. QËLLIMI I PROGRAMIT

Programi orientues për testimin e kandidatëve të lëndës së kimisë është hartuar për të mbështetur dhe për të nxitur zhvillimin profesional të tyre. Ai ofrohet si një program orientues për t’u ardhur në ndihmë të gjithë kandidatëve dhe mësuesve të lëndës së kimisë në arsimin parauniversitar për të realizuar veprimtaritë trajnuese.

Programi synon:

- rritjen e përgjegjshmërisë së kandidatëve dhe të mësuesve për njohjen dhe zbatimin e legjislacionit arsimor e në mënyrë të veçantë të risive më të fundit të reformës arsimore.

¹ Dokumentet ligjore, urdhëresat dhe udhëzimet e MAS-it që zbatohen në shkollë duke u përqendruar në ato të viteve të fundit.

- rritjen e kompetencave profesionale të kuadrit mësimdhënës, për të ndikuar drejtpërdrejt në efektivitetin e procesit mësimor;
- rritjen e aftësive në fushën pedagogjike për mësimdhënie strategjike, për përzgjedhjen e modeleve për organizimin e klasës, për shtjellimin e koncepteve, për nxitjen e diskutimeve, për përdorimin e teknikave për vlerësimin e nxënësve etj;
- rritjen e përgjegjshmërisë së mësuesve për domosdoshmërinë e njohjes së koncepteve bazë dhe ligjësive shkencore të lëndës, si dhe të zbatimit të tyre në praktikë, në përputhje me specifikat e moshës së nxënësve dhe të klasës ku japin mësim;
- rritjen e përgjegjshmërisë së mësuesve për njohjen dhe zbatimin e rregullave të etikës dhe komunikimit në punën e tyre në shkollë;
- rritjen e aftësive të mësuesve në drejtim të zbatimit me saktësi të rregullave drejtshkrimore të shqipes;
- demonstrimin konkret të aftësive shkencore dhe kompetencave të fituara, në mënyrë të veçantë nëpërmjet vlerësimit të arritjeve përmes testimit.

III. PËRMBAJTJA E PROGRAMIT

Programi orientues për testimin e kandidatëve të kimisë është strukturuar sipas fushave kryesore të zhvillimit profesional, të përmendura më sipër. Për secilën fushë, përpos kompetencave profesionale, janë renditur edhe njohuritë dhe aftësitë bazë që duhet të zotërojnë mësuesi i lëndës së kimisë.

Përshkallëzimi i njohurive dhe i aftësive profesionale, të cilat lidhen me kompetencat e secilës fushe të testimit, do ta ndihmojnë kandidatin (mësuesin) që të identifikojë nevojat e tij, si dhe çështjet në të cilat duhet të përqendrohet.

Për të qenë lehtësisht i përdorshëm, programi është paraqitur sipas një formati të caktuar. Sipas këtij formati, për secilën fushë prezantohen kompetencat dhe rezultatet që priten të zotërojnë mësuesi në fushën e njohurive dhe të aftësive, si dhe literatura përkatëse rekomanduese në funksion të tyre.

FUSHA: DOKUMENTE ZYRTARE	
Kompetenca “Zbatimi me përgjegjshmëri i kërkesave të legjislacionit dhe të dokumentacionit shkollor”	Literatura e rekomanduar

<p>Rezultatet e pritshme:</p> <p><i>Mësuesi i kimisë:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - zotëron ligjin për sistemin arsimor parauniversitar, si dhe dispozitat normative të këtij sistemi; - zbaton legjislacionin, udhëzimet dhe rregulloret për hartimin dhe zbatimin e kurrikulës shkollore; - zbaton legjislacionin, udhëzimet dhe rregulloret për personelin e shkollës; - demonstroi zbatimin konkret të udhëzimeve të MAS-it, në funksion të përmirësimit të procesit të mësimdhënie-nxënies; - zbaton etikën profesionale të mësuesit; - respekton të drejtat dhe liritë e nxënësit; - respekton detyrat, të drejtat dhe liritë e mësuesit; - zbaton rregulloret dhe udhëzimet për zhvillimin profesional të mësuesit. 	<ul style="list-style-type: none"> - Ligji nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. - Urdhri për miratimin e Dispozitave Normative për arsimin parauniversitar (DN), nr 343, datë 19.08.2013. - Udhëzimi nr. 16, datë 03.08.2016 “Për vitin shkollor 2016-2017 në sistemin arsimor parauniversitar”. - Udhëzimi nr. 44, datë 16.10.2014 “ Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 21 datë 23.07.2010 “Për normat e punës mësimore- edukative dhe numrin e nxënësve për klasë në institucionet e arsimit parauniversitar”. - Udhëzimi nr. 5, datë 25.02.2013 “Për standardet e mësuesit”. - Udhëzimi nr. 26, datë 15.08.2015 “Zhvillimin profesional të punonjësve arsimorë”. - Udhëzimi nr. 2, datë 12.02.2015 “Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të mësuesve”. - Karta e Performancës së shkollës. - Standardet e shkollës si qendër komunitare. - Udhëzimi nr. 34, datë 11.09.2015 “Për vlerësimin e nxënësve për kurrikulën me kompetenca në arsimin bazë”. - Udhëzimi nr. 14, datë 28.07.2016 “Për vlerësimin e nxënësve në arsimin e mesëm të lartë”.
--	--

FUSHA: PROGRAME LËNDORE

<p>Kompetenca</p> <p>“Zbatimi në mënyrë efektive i programeve të kimisë në shkollë”</p>	<p>Literatura e rekomanduar</p>
---	--

<p>Rezultatet e pritshme</p> <p><i>Mësuesi i kimisë:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - zbaton programin e kimisë duke respektuar të gjitha kërkesat dhe rubrikat e tij; - përshtat programin lëndor në përputhje me veçoritë e mjedisit në të cilin jep mësim; - përdor me efikasitet, në dobi të prirjeve bashkëkohore, fleksibilitetin e zbatimit të programit; - gjen ose harton materiale plotësuese kurrikulare që ndihmojnë në përvetësimin e koncepteve dhe aftësive të parashikuara në program; - gjen ose harton materiale plotësuese kurrikulare që pasurojnë formimin e nxënësve dhe nxitin mendimin e pavarur dhe kritik të tyre; - harton rezultate të nxëni për tema mësimore ose grup temash, kapitujsh, në përputhje me kompetencat e programit; - tregon koherencën vertikale të kurrikulës (vazhdimësia dhe përshtatshmëria e programeve të kimisë); - shpjegon lidhjen program-tekst nxënësi; - përzgjedh mjetet mësimore të nevojshme për të realizuar përmbushjen e kompetencave; - siguron informacion që demonstroi lidhjen e kimisë me shkencat e tjera dhe me jetën reale. 	<ul style="list-style-type: none"> - Korniza kurrikulare 2014. - Programet aktuale lëndore të kimisë për arsimin bazë, klasat 1-9. - Programet aktuale lëndore të kimisë për arsimin e mesëm të lartë, klasat 10-12. - Programet aktuale lëndore të kimisë për arsimin profesional. - Programet aktuale lëndore të kimisë për arsimin e orientuar (social – kulturor). - Programet e reja (2015) të bazuara në kompetenca për klasat 1,2,3 dhe për klasat 6,7,8.
---	--

FUSHA: ASPEKTE TË PEDAGOGJISË, METODOLOGJISË DHE PËRDORIMIT TË TIK-UT NË MËSIMDHËNIE-NXËNIE	
Kompetenca I	

<p align="center">“Zotërimi i njohurive pedagogjike specifike të nevojshme dhe të mjaftueshme për mësimdhënien e kimisë”</p>	<p align="center">Literatura e rekomanduar</p>
<p>Rezultatet e pritshme</p> <p><i>Mësuesi i kimisë:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - demonstroi përkushtim, motivim dhe përgjegjësi gjatë punës së tij; - përshtat punën e tij me zhvillimin fizik, social, emocional dhe konjitiv të nxënësve; - demonstroi respekt, besim dhe objektivitet me nxënësit; - identifikoi nxënësit me nevoja të veçanta (nxënësit me vështirësi në të nxënë dhe nxënësit e talentuar); - planifikoi punën afatshkurtër dhe afatgjatë me nxënësit me nevoja të veçanta; - demonstroi qëndrim pozitiv ndaj shkencës dhe ndaj lëndës së kimisë; - edukoi të nxënësit dashurinë dhe kërshërinë ndaj lëndës së kimisë; - motivoi nxënësit duke e konsideruar motivimin një nga çelësat e progresit të tyre; - krijoi klimë të përshtatshme, motivuese dhe të kënaqshme për nxënësit; - punoi me prindërit për përmirësimin e progresit të nxënësit. 	<ul style="list-style-type: none"> - Situatat e të nxënësit, IZHA, 2015. - Korniza e vlerësimit të nxënësit, MAS, 23.07.2015. - Udhëzuesi i gjimnazit, 2016. - Nivelet e arritjes (arsimi bazë dhe arsimi i mesëm), 2016. - Literaturë që ka në fokus aspekte pedagogjike të punës së mësuesit me nxënësit e tij.
<p align="center">Kompetenca II</p> <p align="center">“Përdorimi i metodave dhe i strategjive efektive në mësimdhënien e kimisë”</p>	<p align="center">Literatura e rekomanduar</p>
<p>Rezultatet e pritshme:</p> <p><i>Mësuesi i kimisë:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - përzgjedh metodat dhe teknikat e përshtatshme për arritjen e një objektivi të 	<ul style="list-style-type: none"> - Situatat e të nxënësit, IZHA, 2015. - Korniza e vlerësimit të nxënësit, MAS, 23.07.2015. - Literaturë që ka në fokus metodat e

<p>caktuar;</p> <ul style="list-style-type: none"> - përdor metoda e teknika që nxisin mendimin e pavarur e krijues të nxënësve; - planifikon një orë mësimore duke u bazuar në mësimdhënien me në qendër nxënësin; - përdor metoda e teknika që nxisin zhvillimin e të menduarit kritik të nxënësve; - përdor metoda e teknika që sigurojnë barazinë dhe gjithëpërfshirjen; - përdor proceset kimisë në mësimdhënien – nxënien e kimisë; - demonstron teknika të ndryshme për vlerësimin e nxënësit; - shpjegon parimet e hartimit të një testi. 	<p>mësimdhënies ndërvepruese me në qendër nxënësin, si dhe metodologjinë e mësimdhënies së kimisë.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Udhëzues dhe materiale mbështetëse që orientojnë për hartimin e rezultateve të të nxënës të orës së mësim, për përgatitjen e planit ditor të mësuesit, për organizimin e orës së mësim.
<p>Kompetenca III</p> <p>“Përdorimi i teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit për të rritur cilësinë e mësimdhënies dhe nxënies në kimisë”</p>	<p>Literatura e rekomanduar</p>
<p>Rezultatet e pritshme</p> <p><i>Mësuesi i kimisë:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - prezanton materiale për kiminë duke përdorur teknologji të përshtatshme si: Power Point, Excel, Math Type në Word; - nxit nxënësit të bëjnë prezantime në kimi duke përdorur programe kompjuterike të njohura për ta; - gjen dhe përdor materiale nga Website për të pasuruar dhe për të perfeksionuar mësimdhënie-nxënien; - përfshin nxënësit në projekte kurrikulare të lëndës së kimisë apo në projekte kurrikulare të integruara të cilat ndërthuren me kërkime, gjetje dhe përdorime materialesh nga Website. 	<ul style="list-style-type: none"> - Literaturë që ka në fokus përdorimin e TIK-ut në mësimdhënie -nxënie.

FUSHA: ASPEKTE TË ETIKËS DHE TË KOMUNIKIMIT

Kompetenca “Zbatimi i rregullave të etikës dhe të komunikimit si elemente të domosdoshme në të gjithë punën e mësuesit”	Literatura e rekomanduar
<p>Rezultatet e pritshme:</p> <p><i>Mësuesi i kimisë:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - njeh rregullat e etikës dhe sjelljes që duhen respektuar në marrëdhënie me drejtuesit e institucionit arsimor, stafin pedagogjik, nxënësit, prindërit dhe komunitetin; - sillet në përputhje me rregullat e etikës dhe të sjelljes në marrëdhënie me drejtuesit, stafin pedagogjik, nxënësit, prindërit dhe komunitetin gjatë punës së tij brenda dhe jashtë institucionit arsimor. 	<ul style="list-style-type: none"> - Kodi i Etikës së mësuesve në arsimin parauniversitar. - Literaturë dhe materiale burimore që trajtojnë çështje të etikës dhe të komunikimit.

FUSHA: ASPEKTE TË DREJTSHKRIMIT TË GJUHËS SHQIPE

Zbatimi i rregullave të drejtshkrimit të gjuhës shqipe	Literatura e rekomanduar
<p>Rezultatet e pritshme:</p> <p><i>Mësuesi i kimisë:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - njeh rregullat e drejtshkrimit të standardit të gjuhës shqipe; - demonstroi zbatimin e rregullave të drejtshkrimit gjatë veprimtarive në institucionin arsimor. 	<ul style="list-style-type: none"> - Literaturë dhe udhëzues metodikë për përdorimin e rregullave të drejtshkrimit të gjuhës shqipe.

FUSHA: PËRMBAJTJA SHKENCORE E LËNDËS

Kompetenca “Respektimi i rigorozitetit shkencor në	Literatura e rekomanduar
---	---------------------------------

mësimdhënien e lëndës së kimisë”	
<p>Rezultatet e pritshme</p> <p><i>Mësuesi i kimisë:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - përshkruan mënyrën e formimit të koncepteve kimisë në klasat 1-9 dhe në klasat 10-12; - demonstroi nivel të lartë shkencor në zbërthimin e koncepteve të programeve lëndore të kimisë; - përshkruan zhvillimin vertikal, nga njëri vit në tjetrin, të koncepteve dhe shprehive; - dallon ndërvarësinë e koncepteve kimike nga njëri - tjetri dhe lidhjen e tyre me konceptet e lëndëve të tjera; - zgjidh me saktësi dhe me mënyra të ndryshme situata problemore, të cilat përdorin konceptet kimike dhe aftësitë e programeve të klasave 1-9 dhe të klasave 10-12; - përdor me efikasitet substancat dhe pajisjet në laboratorin e kimisë. - mbledh informacion të saktë e bindës për nxënësit e tij/saj rreth vlerave përdoruese të kimisë në shkencat tjera dhe në jetën e përditshme. 	<ul style="list-style-type: none"> - Tekste të lëndës për mësuesin dhe nxënësin, si dhe materiale të tjera burimore që mbulojnë përmbajtjen e lëndës.